



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 29 prill 2021

### Njoftim për shtyp

#### Zhvillime të rëndësishme në normat monetare të interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit<sup>1</sup>: mars, 2021

- Norma mesatare e interesit të kredive totale në mars të vitit 2021 shënoi një rënie minimale mujore prej 0,02 p.p. dhe arriti në 4,59%. Në bazë vjetore, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,30 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave totale arriti në 0,89% dhe shënoi një rënie mujore prej 0,03 p.p., ndërsa në bazë vjetore është reduktuar për 0,22 p.p.
- Në mars, norma mesatare e interesit të kredive të reja<sup>2</sup> arriti në 3,94% dhe shënoi një rënie mujore prej 0,31 p.p., ndërsa në bazë vjetore është më e ulët për 0,18 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja shënoi një rritje mujore prej 0,05 p.p. duke arritur në 0,76%. Krahasuar në bazë vjetore, norma mesatare e interesit të depozitave të reja është rritur për 0,22 p.p.

Tabela 1. Norma të interesit të totalit dhe kredive dhe depozitave të reja<sup>3,4,5</sup>

	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	3.2021
во % на годишно ниво							
<b>Вкупни кредити</b>	<b>4.89</b>	<b>4.80</b>	<b>4.70</b>	<b>4.63</b>	<b>4.62</b>	<b>4.61</b>	<b>4.59</b>
Корпоративен сектор	4.08	3.93	3.80	3.73	3.71	3.70	3.70
Домаќинства	5.64	5.63	5.53	5.46	5.45	5.43	5.40
<b>Новоодобрени кредити</b>	<b>4.12</b>	<b>3.94</b>	<b>3.99</b>	<b>3.78</b>	<b>3.98</b>	<b>4.25</b>	<b>3.94</b>
Корпоративен сектор	3.79	3.68	3.82	3.42	3.60	3.76	3.51
Домаќинства	4.83	4.42	4.51	4.38	4.56	4.68	4.61
<b>Вкупни депозiti</b>	<b>1.11</b>	<b>1.09</b>	<b>0.98</b>	<b>0.95</b>	<b>0.93</b>	<b>0.92</b>	<b>0.89</b>
Корпоративен сектор	1.24	1.27	1.14	1.22	1.22	1.20	1.15
Домаќинства	1.10	1.07	0.96	0.92	0.89	0.88	0.86
<b>Новопримени депозiti</b>	<b>0.54</b>	<b>0.64</b>	<b>0.76</b>	<b>0.68</b>	<b>0.62</b>	<b>0.71</b>	<b>0.76</b>
Корпоративен сектор	0.20	0.43	0.74	0.38	0.40	0.39	0.75
Домаќинства	0.94	0.85	0.78	0.85	0.66	0.86	0.77

Burimi: BPRMV.

<sup>1</sup> „Normë interesit“ do të thotë një normë mesatare e ponderuar e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm, shih Metodologjinë:

[http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia\\_MIR\\_07\\_2018\\_mak.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf)

<sup>2</sup> Zhvillime të ndryshueshme janë karakteristike sa u përket normave të interesit të kredive/depozitave të reja. Zhvillimet e këtylla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.

<sup>3</sup> Efektet e ndryshimeve në metodologjinë të publikuar në informacionin e 20 korrikut të vitit 2018 ([www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija\\_za\\_promeni\\_vo\\_monetarnata\\_statistika\\_mk.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf)) nuk vërehen në kategoritë individuale të normave të interesit të depozitave/kredive (në denarë pa klauzolë valutore, në denarë me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj), por vetëm në normat agregate të interesit (në denarë dhe valutë të huaj) të cilat nuk janë subjekt i analizës në njoftim, por publikohen në internet faqen e BPRMV-së.

<sup>4</sup> Në gusht të vitit 2020 revokohet leja për themelimit dhe punë të një banke. Të dhënat për normat e interesit për korrik të vitit 2020 i përfshinë të dhënat e qershorit për normat e interesit për këto banka.



<sup>5</sup> Të dhënat për normat e interesit të muajit gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelimit dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.



# Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë


## 1. Normat e interesit të sektorit të korporatave<sup>6</sup>

- Norma mesatare e interesit të kredive totale të sektorit të korporatave, në mars, mbeti në nivelin e njëjtë prej 3,70% si në muajin paraprak, ndërsa në bazë vjetore kjo normë e interesit është më e ulët për 0,38 p.p.



Burimi: BPRMV.

- Në mars, norma e interesit e kredive të reja të sektorit të korporatave është 3,51% dhe është reduktuar për 0,25 p.p., në bazë mujore. Ndryshimi në rënie është si rezultat i rënies së normave të interesit në të gjithë komponentët, edhe atë: norma e interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,52 p.p. dhe 0,25 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaja (për 0,05 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit ka shënuar një rënie prej 0,28 p.p.



Burimi: BPRMV.


<sup>6</sup>Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin institucionet jofinanciare (publike dhe të tjera).




## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Këtë muaj, norma e interesit për depozitat totale të sektorit të korporatave regjistroi një rënie mujore prej 0,05 pikë përqindje duke arritur në 1,15%. Analizuar sipas valutës, rënia mujore del nga zvogëlimi i normave të interesit në të gjithë komponentët: normat e interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,07 p.p.) dhe normat e interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,05 dhe 0,01 p.p.). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,09 p.p.
- Në mars, norma e interesit e depozitave të reja<sup>7</sup> të sektorit të korporatave është 0,75% dhe është për 0,36 p.p. më e lartë në bazë mujore. Ndryshimi në rritje është si rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,37 p.p.), dhe normave të interesit të depozitave me klauzolë valutore (për 0,01 p.p.) në kushte të normave të pandryshuara të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore. Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit të depozitave të reja të sektorit të korporatave shënoi një rritje prej 0,55 p.p.

## 2. Normat e interesit të amvisërive<sup>8</sup>



Burimi: BPRMV.



- Në mars, norma e interesit të kredive totale të amvisërive shënon një rënie mujore prej 0,03 p.p. duke arritur në 5,40%. Analizuar sipas valutës, rënia është si rezultat i zvogëlimit të normave të interesit në të gjithë komponentët, edhe atë: normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,04 p.p. dhe për 0,03 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të kredive në valutë të huaja (për 0,01 p.p.). Norma mesatare e interesit të kredive totale të amvisërive është më e ulët për 0,24 p.p., krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



<sup>7</sup>Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të sektorit të korporatave, ndërprerja në serinë e të dhënave për normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit se në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë marrë depozita të tilla nga sektori i korporatave.

<sup>8</sup>Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshinë: persona fizikë, persona të vetëpunësuar dhe institucioni jofitimprurëse të cilat u shërbejnë amvisërive.



## Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Norma mesatare e interesit të kredive të reja të amvisërive, këtë muaj, është 4,61% dhe është reduktuar për 0,07 p.p. krahasuar me muajin paraprak. Ndryshimi është rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,05 p.p.), me një rritje të normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe kredive në valutë të huaj (për 0,12 p.p. dhe 0,08 p.p., përkatësisht). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rënie prej 0,22 p.p.



Burimi: BPRMV.

- Në mars, normat e interesit të depozitave totale të amvisërive ka shënuar një rënie mujore prej 0,02 p.p. duke arritur në 0,86%. Rënia, plotësisht shpjegohet me normat e reduktuara të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,04 p.p.), në kushte të normave të pandryshuara të interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore. Norma mesatare e interesit e totalit të depozitave të amvisërive shënoi një rënie prej 0,24 p.p. në bazë vjetore.
- Në mars, norma e interesit të depozitave të reja të amvisërive<sup>9</sup> arriti në 0,77% duke shënuar një rënie mujore prej 0,09 p.p. Ndryshimi në rënie është si rezultat i normave të zvogëluara të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,16 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,07 p.p.). Edhe këtë muaj, bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Krahasuar me marsin e vitit të kaluar, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,17 p.p.

\*\*\*

<sup>9</sup>Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja në seritë e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



## **Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë**

### **Informacione shoqëruese**

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit  
[http://www.nbrm.mk/statistika\\_na\\_kamatni\\_stapki.nspk](http://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki.nspk)

Shpjegime metodologjike:

[http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia\\_MIR\\_07\\_2018\\_mak.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf)

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

[http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar\\_na\\_objavuvanje\\_podatoci.pdf](http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf)

Të dhëna mujore për normat e interesit: 31 maj i vitit 2021 (mesatare referuese prill 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: [contact.statistika@nbrm.mk](mailto:contact.statistika@nbrm.mk) ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).